



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivery	29.06.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKENUESHAK	4957/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.728/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2571/20221 të datës 29.05.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.728/2021 të datës 06.08.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: kundër Vendimit me numër Protokoli:184 të datës 09.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 29.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.728/2021 e datës 06.08.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me numër Protokoli:184 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 09.07.2021.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës me datë 06.08.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me Nr. prot: 4122/2021, kundër Vendimit me numër protokoli:184 të datës 09.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon s akti i kontestuar është i kundërligjshëm ngase e me rastin e transferimit të tij, institucioni punëdhënës ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik,

dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitat e Rregullores Nr.26/2020 për Klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.08.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Administrata Tatimore të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 20.08.2021 ka pranua nga Administrata Tatimore të Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokoli: 4284/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në kohën e parashtrimit të ankesës nga ankuesi ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 17.07.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke e udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 29.05.2023 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2571/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 17.09.2021 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 06.08.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 06.08.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit me numër protokoli:184 të datës 09.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Akt Emërimit e datës 28.02.2014 të ankuesit; Vendimin me Nr.Prot:191 të datës 16.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së; Kopjen e ID-së së punës për ankuesin; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2018 të datës 16.01.2019; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2020 (tetor-dhjetor) i datës 29.01.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë i datës 11.08.2021; Përgjigje në kërkesë të datës 20.08.2021; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Borxheve; Vendimin me Nr. Prot:09-06-2528 të datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së; Vendimin me Nr. Prot:330 të datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e bazuar, sepse:*

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se, ankuesi sipas Vendimit me Nr. Prot:191 të datës 16.03.2016 ka qenë i emëruar në pozitën "Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Programe dhe Procedura" në Administratën Tatimore të Kosovës. Tutje, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, më datë 13.06.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 09-06-2528 me të cilin ka bërë shfuqizimin e Akt Emërimit për pozitën e ankuesit, ndërsa po të njëjtën ditë, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës përmes Vendimit me

numër prot:330 të datës 13.06.2023 ankuesin e cakton në pozitën Ushtrues Detyre të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Programe dhe Procedura.

Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, përmes Vendimit me numër protokoli:184 të datës 09.07.2021, ankuesin nga pozita Ushtrues Detyre të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Programe dhe Procedura e transferon në pozitën Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve me arsyetimin përmbushjes së objektivave në fushën e menaxhimit të mbledhjeve së borxheve dhe të njëjtin transfer e mbështet në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Përpara se të shqyrtohen pretendimet ankimore të ankuesit, për shkaqe objektive dhe procedurale, Kolegji i Këshillit thekson faktin se është me rëndësi të konstatohet fakti se Këshilli ka nxjerrë dy vendime të cilat e kanë fituar titullin e ekzekutueshmerisë, gjegjësisht Vendimin A.nr.461/2021 të datës 23.06.2021 dhe A.nr.484/2021 të datës 18.06.2021, përmes të cilave Këshilli i kishte aprovuar ankesat e ankuesve B.Sh dhe H.H, ndërsa e kishte anuluar aktin e përbashkët administrativ, respektivisht Vendimin me Nr.09-06-2528 të Drejtori të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës të datës 13.06.2019, përmes të cilit vendim Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, kishte shfuqizuar Vendimi me Nr. Prot:191 të datës 16.03.2016 për emërimin e ankuesit Nahit Sharku në pozitën "Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Programe dhe Procedura" dhe po ashtu përmes të njëjtët vendim kishte shfuqizuar edhe emërimet e dy ankuesve B.SH dhe H.H.

Ankuesi, sikurse edhe dy kolegët e tij, ndaj të njëjti akt kishin parashtruar ankesa në vitin 2019, për dy rastet e tjera sikurse u përcaktua edhe më lartë Këshilli ka vendosur, ndërsa për ankesën e ankuesit nuk kishte mundur të vendos për shkak të mungesës së Kolegjeve apo emërimit të anëtarëve të Këshillit dhe lënda është në proces gjyqësor si lëndë e pavendosur, mirëpo kurdo që Gjykata e detyron Këshillin të vendos, në aspektin objektiv çështje është e vendosur, ngase Vendimi me Nr.09-06-2528 i Drejtori të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 13.06.2019 është anuluar, dhe se përmes të njëjtit vendim ishin shfuqizuar emërimet e ankuesve B.Sh, H.H dhe ankuesit, prandaj për aq kohë sa një akt administrativ i përbashkët që ka cenuar të drejtat e tre (3) ankuesve është anuluar përmes dy vendimeve të Këshillit, atij me shifër A.nr.461/2021 të datës 23.06.2021 dhe A.nr.484/2021 të datës 18.06.2021, i njëjti akt nuk mund të prodhojë efekte juridike as për ankuesin në rastin konkret.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe paragrafin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 6.Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme." dhe nenit 4 paragrafi 1 dhe 4, nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil sikurse përcaktohet që: "4.1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit; 4.4. Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit; 5.2. Transferimi i përkohshëm në interes të

institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet” dhe ka ardhur në përfundimin se institucioni mund të bëjë transferimin e nëpunësve civil kur është në interes të institucionet sipas afatit të përcaktuar jo më shumë se gjashtë (6) muaj për gjatë dy (2) viteve, mirëpo paraprakisht duhet plotësuar edhe parakushtet e tjera ligjore sikurse që transferimi mund të bëhet vetëm brenda së njëjtës kategori, përcaktimi i afatit se sa do të zgjasë transferi është i detyrueshëm me sigurinë që nëpunësi civil pas përfundimit të transferimit të kthehet në pozitën që ka qenë duke e ushtruar paraprakisht, ndërsa kompetent për nxjerrjen e vendimit për transferimin e nëpunësit civil është Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Për sa më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër protokoli:184 i datës 09.07.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, përmes të cilit e ka transferuar ankuesin është vendim i paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë;; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material” pasi vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit material të përcaktuar me 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe paragrafin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 4 paragrafi 1 dhe 4, nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil ndërlidhur me nenin 52 paragraf 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pasi që fillimisht pozita në të cilën ankuesi është i emëruar “Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Programe dhe Procedura”, nuk është pozitë e së njëjtës kategori me pozitën në të cilën është transferuar “Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve” sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 10 dhe nenit 11 Rregullores 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, po ashtu vendimi i kontestuar nuk përmban afatin kohor se sa do të zgjasë transferi sikurse as nuk krijon siguri juridike se ankuesi pas përfundimit të transferimit do të kthehet në pozitën për të cilën është i emëruar dhe po ashtu vendimin në fjalë e ka nxjerrë Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, ndërsa legjislacioni material kompetencën ia ka njohur Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Prandaj nga u tha si më lartë, Kolegji i këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të dispozitave ligjore ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa akti i kontestuar gjegjësisht Vendimi i datës 09.07.2021 me numër protokoli:184 i nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës është akt i paligjshëm për arsyet e dhënë si në arsyetimin e këtij vendimi dhe i njëjti është shfuqizuar.

Kolegji i Këshillit po ashtu, thekson faktin se në rastin konkret institucioni punëdhënës i ankuesit nuk ka arritur të zbatoj drejtë apo ka vepruar në kundërshtim me parimeve e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publik sikurse përcaktohet Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik në nenin 7: “Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe

paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.728/2021

AvdyL BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

[Signature]
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

